

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7926
E premte, 8 nëntor 2024
Çmimi 0.50

Osmani në Hungari:
Nuk e shoh Trumpin kërcënim,
u bëmë të pavarur kur
republikanët ishin në pushtet,
të lirë kur ishin demokratët



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAPORTET TRUMP - KOSOVË: ÇFARË ISHIN DHE ÇFARË MUND TË PRITET?

FAQE 4-5



Marrëveshja ekonomike në Kosovë - Serbi në Uashington, mospajtimet politike dhe akuzat e ndërsjella kanë qenë disa nga ngjarjet që kanë shënuar raportet e Prishtinës zyrtare me administratën e kaluar ku në krye ishte Donald

Trumpi. Tani kur Trumpi është rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, njohësit politikë në Kosovë dhe të huaj kanë qëndrime të ndara për ndikimet që kjo administratë do të ketë mbi Kosovën. Në këtë drejtim, profesori Afrim Hoti ka

shprehur optimizëm se Trumpi do të sjellë një "mundësi pozitive për Kosovën dhe rajonin", ndërsa analisti Toby Vogel ka thënë se "as edhe një gjë pozitive" për Ballkanin nuk mund të vijë nga zgjedhja e presidentit të ri amerikan

BE-JA: QEVERIA NUK MUND T'UA BARTË KOMUNAVE PËRGJEGJËSITË PËR ASOCIACIONIN

F. 3



JOSEPH: KURTI DO TË PËRBALLET ME ZGJIDHJE TË VËSHTIRA NËSE GRENELLI EMËROHET NË NDONJË POZITË TË LARTË NË POLITIKËN E JASHTME

F. 4



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ÇITAKU: RAPORTET ME SHBA-NË VAREN EDHE NGA KUSH UDHËHEQ INSTITUCIONET E KOSOVËS

F. 5

LDK-ja DORËZON NË KUSHTETUESE LIGJIN PËR ZYRTARËT PUBLIKË

F. 6

HAXHIU: PËR ASNJË RAST TË DHUNËS NË FAMILJE NUK ËSHTË SHOQIPTUAR DËNIMI MAKSIMAL

F. 7

AAK-ja: MIRATIMI I PLANIT HAPËSINOR, DETYRË URGJENTE

F. 6

EKONOMI



FOL-i KRITIKON QEVERINË PËR PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2025: PO PROPOZON PRAKTIKA TË GABUARA LIGJVËNËSE

F. 8

GJYKATA KOMERCIALE SHIHET SI "SHPËTIM" PËR BIZNESET

F. 8

SPORT



DRITON KUKA LË TË HAPUR MUNDËSINË E KANDIDIMIT PËR PRESIDENT TË KOK-ut

F. 10

Osmani në Hungari: Nuk e shoh Trumpin kërcënim, u bëmë të pavarur kur republikanët ishin në pushtet, të lirë kur ishin demokratët

BUDAPEST, 7 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është për vizitë në Hungari në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik të Evropës. Ajo para fillimit të samitit ka thënë se beson fuqishëm se do të vazhdojë bashkëpunimi ndërmjet Evropës dhe ShBA-së edhe gjatë administratës së presidentit Donald Trump. E para e shtetit të Kosovës është pyetur edhe lidhur me raportet Kosovë - ShBA pas zgjedhjes së Trumpit president. "Kosova e ka pasur mbështetjen dypartiake të secilës administratë të ShBA-së që në fillimet e viteve '90. Jemi bekuar me atë mbështetje dhe

për këtë kemi çdo arsye të besojmë se mbështetja do të vazhdojë edhe me administratën e presidentit Trump", është shprehur Osmani. Më tutje, Osmani ka thënë se nuk e sheh kërcënim për Kosovën zgjedhjen e Trumpit president pasi Kosova gjithnjë ka pasur mbështetje nga republikanët dhe demokratët. "Nuk e shoh si kërcënim. Kosova, në fakt, ka përfitur për dekada nga një mbështetje dypartiake nga Shtetet e Bashkuara. Në u bëmë të pavarur kur republikanët ishin në pushtet. Ne u bëmë të lirë kur demokratët ishin në

pushtet... Ne kemi punuar shumë ngushtë me çdo administratë dhe besoj fuqimisht se do të vazhdojë të jetë kështu", ka thënë ajo. Duke folur për Samitin e Komunitetit Politik të Evropës, Osmani ka thënë se është një mundësi e mirë për të diskutuar dhe gjetur zgjidhje për sfidat. E para e shtetit është pyetur edhe nëse do të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Osmani ka thënë se bisedimet Kosovë - Serbi vazhdojnë në Bruksel në mes të kryenegociatorëve, kryesisht në atë se si mund të vazhdohet zbatimi i marrëveshjeve të arritura.



Plani i Trumpit për Ukrainën: Mbrojtja do të vijojë, NATO shtyhet për 20 vjet, krijohet një zonë e çmilitarizuar

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Një ide brenda ekipit të presidentit të zgjedhur të ShBA-së, Donald Trump, për t'i dhënë fund luftës së Ukrainës, përfshin shtyrjen e anëtarësimit të Kievit në NATO për të paktën 20 vjet, në këmbim të furnizimeve të vazhdueshme me armë, raporton "Wall Street Journal (WSJ)", duke cituar tri burime të afërta me Trumpin.

Trumpi, i cili ka fituar zgjedhjet presidenciale më 5 nëntor, ka thënë vazhdimisht se do t'i japë fund luftës brenda "24 orëve" dhe do ta largojë ShBA-në "nga Ukraina".

Raportet e mëparshme të medieve dhe deklaratat nga rrethi i brendshëm i Trumpit kanë treguar se kjo do të sillte ngrirjen e luftës në linjat aktuale të frontit dhe krijimin e një zone të çmilitarizuar në lindje, një pretendim i mbështetur edhe nga burimet e "WSJ"-së.

Rusia aktualisht pushton



afërsisht 20 për qind të territorit ukrainas në jug dhe në lindje dhe vazhdon t'i shtyjë në mënyrë të qëndrueshme mbrojtësit ukrainas, megjithëse me koston e humbjeve të rënda. Mbetet e paqartë se kush do ta kontrollonte zonën e

çmilitarizuar prej 1 300 kilometrash, por një ndihmës i panjohur i Trumpit i ka thënë "WSJ" se Uashingtoni do t'u kërkonte aleatëve evropianë t'i dërgonin trupat e tyre. Ky propozim është vetëm një nga idetë që qarkullojnë në ekipin e Trumpit dhe

presidenti i zgjedhur ka një tendencë për të marrë vendime të rëndësishme politike në vend, kanë thënë burimet. Dy nga këshilltarët e Trumpit, gjenerali në pension Keith Kellogg dhe Fred Fleitz, kanë propozuar në qershor që të ndërpritet ndihma ushtarake për Ukrainën, nëse ajo nuk pranon të mbajë negociatë paqeje me Rusinë. Në të njëjtën kohë, Kellogg ka thënë se plani do të sillte paralajmërim shtesë për Rusinë se ShBA-ja do të rrisë mbështetjen ushtarake për Ukrainën nëse ajo refuzon kushtet e armëpushimit. Fleitz ka thënë se Trumpi ka reaguar pozitivisht ndaj planit, por ka shtuar: "Unë nuk po pretendoj se ai ishte dakord me të ose ishte dakord me çdo fjalë të tij". Plani përfshinte heqjen e pranimit të Ukrainës në NATO nga tavolina për "një periudhë të zgjatuar në këmbim të një

marrëveshjeje paqeje gjithëpërfshirëse dhe të verifikueshme me garanci sigurie".

Ukraina ka paraqitur një kërkesë për anëtarësim në NATO në vitin 2022, por nuk ka marrë një ftesë, duke marrë një përgjigje të ftohtë nga presidenti i ShBA-së, Joe Biden, kancelari gjerman Olaf Scholz dhe të tjerë.

Si Kievi ashtu edhe Moska thanë se nuk do të ishte e mundur ta përfundonin luftën brenda 24 orëve, siç pretendon Trumpi. Ukraina ka qenë e vendosur për mosnjohjen e pushtimit rus të territoreve të saj, por ka pranuar se disa duhet të çlirohen me mjete diplomatike. Nga ana tjetër, Rusia aktualisht mban dorën e sipërme në fushën e betejës, duke tejkuluar në numër dhe duke tejkuluar trupat ukrainase, me gjasë që ka pak nxitje për të kërkuar një zgjidhje.

Izraeli nënshkruan marrëveshje për blerjen e 25 avionëve luftarakë F-15

JERUSALEM, 7 NËNTOR - Ministria e Mbrojtjes e Izraelit ka njoftuar të enjten se e ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e 25 avionëve luftarakë të gjeneratës së ardhshme, F-15, nga kompania "BoeingCo". Ajo ka thënë se marrëveshja, e vlefshme 5.2 miliardë dollarë, është pjesë e një pakete të gjerë e ndihmës amerikane të miratuar nga administrata amerikane dhe

Kongresi në fillim të këtij viti, që përfshinte edhe mundësinë për 25 avionë luftarakë shtesë. Izraeli do të fillojë t'i pranojë F-15-shat në vitin 2031, nga 4-6 sosh në vit, sipas saj. Avionët luftarakë do të jenë të pajisur me sisteme izraelite të armatimit. "Këto përparësi do t'ia mundësojnë Forcës Ajrore të Izraelit ta ruajë superioritetin e vet strategjik përballë sfidave të tanishme dhe të ardhshme

në Lindjen e Mesme", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes së Izraelit. Drejtori i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Eyal Zamir, ka thënë në një komunikatë se qeveria izraelite ka siguruar marrëveshje prokurimi në vlerë gati 40 miliardë dollarë prej se filloj lufta në Rripin e Gazës më 7 tetor 2023. Për Boeing, marrëveshja për

shitjen e avionëve F-15 është ujdja e dytë e madhe këtë vit. Në gusht, El Al Israel Airlines ka nënshkruar marrëveshje me Boeing për blerjen e rreth 31 avionëve 737, në vlerë rreth 2.5 miliardë dollarë. Ido Nehushtan, president i Boeing Israel, tha se marrëdhëniet e kompanisë me Izraelin datojnë që nga themelimi i Izraelit dhe "ne do të vazhdojmë të punojmë me qeverinë e



ShBA-së dhe të Izraelit për dorëzimin e avionëve të avancuar luftarakë F-15 përmes kanaleve standarde të prokurimit ushtarak".

BE-ja: Qeveria nuk mund t'ua bartë komunave përgjegjësitë për Asociacionin

BRUKSEL, 7 NËNTOR - Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk mund ta hartojë Statutin e Asociacionit jashtë dialogut të lehtësuar në Bruksel.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se BE-ja e mbështetur nga vendet e saj anëtare dhe partnerët e saj, përfshirë ShBA-në, zyrtarisht e ka paraqitur draft-statutin evropian për krijimin e Asociacionit. Ai ka thënë se ky draft i është paraqitur personalisht kryeministrit Kurti nga lehtësuesi i BE-së së bashku me këshilltarët e sigurisë kombëtare të Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë si dhe nga përfaqësuesi i posaçëm i ShBA-së. Stanoka thënë se Qeveria e Kosovës nuk mund të heqë dorë nga përgjegjësitë e saj të dialogut ose t'i delegojë ato te komonat me shumicë serbe. "Në vitin 2013 Kosova nënshkroi marrëveshjen e Brukselit, e cila u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me shumicë prej dy të tretave. 11 vjet më vonë, Kosova ende nuk i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm drejt krijimit të saj dhe për këtë arsye po dështon përmbushjen e detyrimit të saj të qartë sipas ligjit ndërkombëtar, i cili më pas u përsërit në marrëveshjet e 2015-s dhe 2023-s. Sipas marrëveshjeve përkatëse të dialogut të 2013-s dhe 2015-s, statuti për themelimin e ASM-së duhet të hartohet dhe të diskutohet në dialog. Çdo propozim duhet të diskutohet me Serbinë dhe

ndërmjetësuesin e BE-së dhe të jetë në përputhje me marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015. Kjo, gjithashtu, do të thotë se Qeveria e Kosovës nuk mund ta hartojë Statutin jashtë dialogut", ka thënë Stano për "RTV21".

Kryeministri Albin Kurti ka refuzuar ta themelojë Asociacionin mbi propozimin evropian duke thënë se "ne e kemi një asociacion të komunave, nëse dikush e dëshiron një tjetër, kjo duhet të bëhet nga komuna. Nuk formon kryeministri asociacion e as nuk i themelon".

Por, Bashkimi Evropian ka vlerësuar se qeveria nuk mund t'u shmanget përgjegjësi që ka marrë në procesin e dialogut dhe ato t'ua delegojë komunave me shumicë serbe. Sipas zëdhënësit të BE-së, Peter Stano, drafti i Asociacionit i është dorëzuar kryeministrit Kurti personalisht nga lehtësuesi i BE-së së bashku me këshilltarët e Sigurisë Kombëtare të Francës, të Gjermanisë dhe të Italisë si dhe nga përfaqësuesi special i ShBA-së. "Qeveria nuk mund të heqë dorë nga përgjegjësitë e saj në kuadër të dialogut apo t'ua delegojë ato komunave me shumicë serbe të Kosovës. Në tetor 2023, në një përpjekje për ta çuar përpara procesin e normalizimit, BE-ja, e mbështetur nga shtetet anëtare dhe partnerët e saj si ShBA-ja, paraqiti zyrtarisht një projekt-statut evropian për krijimin e Asociacionit. Ky draft-statut



evropian bazohet në modelet dhe praktikën e mira evropiane, si dhe në kornizën ligjore të Kosovës. Drafti iu dorëzua kryeministrit Kurti personalisht nga facilitatori i BE-së së bashku me këshilltarët e sigurisë kombëtare të Francës, të Gjermanisë dhe të Italisë si dhe nga përfaqësuesi special i ShBA-së", ka thënë ai.

Përveç dorëzimit të draft-statutit evropian në Qeverinë e Kosovës nga emisarët evropianë dhe amerikanë, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka rikujtuar se drafti i ngjashëm ishte pranuar nga kryeministri Kurti dhe presidenti serb Vuçiq edhe në takimin e 26 tetorit 2023 në Bruksel.

"Në një takim të nivelit të lartë në mbështetje të dialogut në prani të presidentit Macron, kryeministres Meloni dhe kancelarit Scholz, të dyja palët

pranuan në parim draft-statutin evropian. Në konkluzionet e tij të dhjetorit 2023, Këshilli Evropian përhëndeti 'gatishtërinë e Serbisë dhe të Kosovës për ta pranuar draft-statutin e paraqitur palëve nga lehtësuesi i BE-së'. Kjo është një njohje zyrtare e dokumentit nga 27 shtetet anëtare të BE-së. Etiketi i projektstatutit evropian si 'thjesht një non-paper' shpërfill ftesën e Këshillit të Bashkimit Evropian për të vazhduar mbi këtë bazë dhe vonon më tej perspektivën e krijimit të tij", ka thënë Stano. Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje Kosovës të ndërmarrë hapa konkretë për themelimin e Asociacionit, ndërsa për Serbinë përmbushjen e obligimeve të saj që rrjedhin nga marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve. "Na vjen keq që një vit pasi palët miratuan dokumentin në parim,

nuk u bë asnjë përparim për krijimin e tij në përputhje me draft-statutin evropian. Në përputhje me riangazhimin e saj zyrtar ndaj dialogut dhe zbatimit e plotë të të gjitha marrëveshjeve të dialogut të 20 shtatorit 2024, ne i bëjmë thirrje Kosovës të ecë përpara me themelimin e saj pa vonesa të mëtejshme. Serbia pritet t'i përmbushë obligimet e saj që rrjedhin nga marrëveshja për rrugën e normalizimit, paralelisht me Kosovën që të ecë përpara me themelimin e Asociacionit bazuar në draft-statutin evropian, në përputhje me planin e zbatimit të propozuar nga lehtësuesi i BE-së", ka thënë Stano.

Qeveria e Kosovës përmes një përgjigjeje nga zëdhënësi Përparim Kryeziu, ka thënë se insistojnë të ketë nënshkrim të marrëveshjes bazike dhe aneksit të saj të zbatimit, duke kërkuar të respektohet rendi i gjërave në proces të dialogut. "Prandaj, nuk mundemi që një vit pas takimit të tetorit të vitit të kaluar, në të cilin refuzohet oferta jonë për nënshkrimin e paketës, të nxjerrim draft-statutin e BE-së nga paketa e ta hedhim paketën e njohjes së paku de facto reciproke. Rikujtojmë se draft-statuti i BE-së nuk e ka nënshkrimin as të përfaqësuesit të lartë të BE-së, Borrell, as të emisarit të tij Lajçak, aq më pak të kryeministrit Kurti. Statusi i draft-statutit është ai i një 'non-paper'-i, një ndër disa propozimet që janë bërë në vitet e kaluara", ka thënë Kryeziu.

Britania do të nënshkruajë marrëveshje me Kosovën dhe vendet e tjera të Ballkanit për t'i luftuar bandat e trafikimit të njerëzve

LONDËR, 7 NËNTOR - Kryeministri britanik Keir Starmer do të nënshkruajë marrëveshje të reja për t'i penguar bandat kriminale që kontrabandojnë emigrantë nëpër Ballkanin Perëndimor, si pjesë e përpjekjeve për t'i bllokuar vendkalimet me varka të vogla.

Sir Keir Starmer do t'i bëjë publike marrëveshjet për ta rritur shkëmbimin e inteligjencës, ekspertizën dhe bashkëpunimin me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë në një takim të Komunitetit Politik Evropian në Budapest, Hungari, të enjten, raporton media britanike "Standard".

Ai pritet t'i nxisë partnerët evropianë të ndërmarrin veprime për t'i ndalë vdekjet në Kanalin Anglez gjatë kalimeve me varka të vogla dhe t'u thotë atyre se bashkëpunimi i ligjshëm ndërkombëtar do të jetë çelësi i përpjekjeve.

Mediumi britanik ka shkruar se

Ballkani Perëndimor është një rrugë kyçe e përdorur nga emigrantët që përfundojnë në BE ose Mbretëri të Bashkuar ilegalisht. Pothuajse 100 000 emigrantë udhëtuan në këtë rrugë vitin e kaluar.

Marrëveshjet është thënë se do ta nxisin shkëmbimin e informatave të inteligjencës dhe bashkëpunimin për t'i penguar bandat kriminale ndërsa ato kontrabandojnë njerëz nëpër këto vende. Qëllimi është të arrestohen bandat dhe të thyhen modelet e tyre të biznesit qysh në fillim.

Mbretëria e Bashkuar tashmë është duke punuar me Shqipërinë për t'i luftuar flukset e paligjshme financiare që mbështesin operacionet e bandave të kontrabandës. "Ekziston një perandori kriminale që vepron në kontinentin tonë, duke zhvatur njerëzit dhe duke minuar sigurinë tonë kombëtare. E

mbështetur nga Komanda jonë e re e Sigurisë Kufitare, Mbretëria e Bashkuar do të jetë në qendër të përpjekjeve për t'i dhënë fund plagës së kimit të organizuar të imigracionit – por ne nuk mund ta bëjmë atë të vetëm. Ne duhet të shkojmë më tej dhe më shpejt, së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë, dhe ta çojmë luftën drejtpërdrejt në zemër të këtyre rrjeteve të ndyra të kontrabandës së njerëzve. Unë do ta bëj këtë tipar qendror të diskutimeve të mia në takimin e sotëm të Komunitetit Politik Evropian", është shprehur kryeministri Starmer.

Ndërsa sekretarja e Brendshme britanike, Yvette Cooper, ka thënë se kriminelët nuk kanë ku të fshihen. "Puna jonë me partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor është absolutisht thelbësore për çmontimin e rrjeteve kriminale që orkestrojnë shfrytëzimin e njerëzve të cenueshëm për përfitime financiare. Duke



punuar më ngushtë me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ne do të ndajmë informacione dhe inteligjencë dhe do të punojmë përtej kufijve për të përcaktuar se çfarë po ndodh dhe ku, për t'i thyer modelet e biznesit të këtyre bandave të paskrupullta në burim. Përmes punës sonë të shtuar, kriminelët së shpejti do të kuptojnë se nuk kanë ku të fshihen", është shprehur ajo. Kryeministri britanik ka nisur një

fushatë njëjavore për kalimet me varka të vogla të hënën kur njoftoi 90 milionë euro fonde shtesë për Komandën e tij të re të Sigurisë Kufitare, duke e çuar fondin total në 180 milionë euro.

Ai ka thënë se planifikonte t'i shtynte përpara përpjekjet e Mbretërisë së Bashkuar për të lidhur një pakt sigurie me BE-në, duke përfshirë rivendosjen e qasjes në rrjetet e shkëmbimit të inteligjencës në kohë reale.



Dujar Terstena (RFE/RL)

Raportet Trump - Kosovë: Çfarë ishin dhe çfarë mund të pritet?

Marrëveshja ekonomike në Kosovë - Serbi në Uashington, mospajtimet politike dhe akuzat e ndërsjella kanë qenë disa nga ngjarjet që kanë shënuar raportet e Prishtinës zyrtare me administratën e kaluar ku në krye ishte Donald Trumpi. Tani kur Trumpi është rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, njohësit politikë në Kosovë dhe të huaj kanë qëndrime të ndara për ndikimet që kjo administratë do të ketë mbi Kosovën. Në këtë drejtim, profesori Afrim Hoti ka shprehur optimizëm se Trumpi do të sjellë një "mundësi pozitive për Kosovën dhe rajonin", ndërsa analisti Toby Vogel ka thënë se "as edhe një gjë pozitive" për Ballkanin nuk mund të vijë nga zgjedhja e presidentit të ri amerikan

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Nga marrëveshja ekonomike ndërmjet Kosovës e Serbisë, njohja nga Izraeli, deri te mospajtimet politike dhe akuzat, janë ngjarjet që kanë shënuar raportet e Kosovës me administratën e kaluar amerikane në krye me Donald Trumpin, 2016-2020. Tani që Trumpi është zgjedhur për mandatin e dytë, njohësit politikë në Kosovë dhe të huaj kanë qëndrime të ndara për ndikimet që kjo administratë do të ketë mbi Kosovën. Afrim Hoti, profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, shpreh optimizëm se Trumpi do të sjellë një "mundësi pozitive për Kosovën dhe rajonin". Ndërsa për Toby Vogel, nga Këshilli për Politikën e Demokrazimit në Berlin, "as edhe një gjë pozitive" për Ballkanin nuk mund të vijë nga zgjedhja e Trumpit.

Normalizim ekonomik dhe konflikte politike

Gjatë mandatit të parë të Donald Trumpit president i ShBA-së (2016-2020) administrata e tij u përqendrua fuqimisht në atë që e quajti "normalizim ekonomik" të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Synimi kryesor, sipas asaj administrate, ishte që bashkëpunimi ekonomik t'i vendoste "në plan të parë përfitimet e qytetarëve, duke i ulur tensionet politike në rajon". I dërguari i posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka luajtur një rol kyç në këtë përpjekje, duke theksuar se mungesa e një marrëveshjeje të tillë përbente një pengesë të madhe për zhvillimin ekonomik të të dyja vendeve dhe për tërheqjen e investimeve të huaja. Në katër vjetët sa president i

ShBA-së ishte Trumpi, në Kosovë janë ndërruar tre kryeministra: Ramush Haradinaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Një moment i rëndësishëm i ndërmjetësimit të administratës Trump, në marrëdhëniet Kosovë - Serbi ndodhi më 4 shtator 2020, kur presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Avdullah Hoti, e nënshkruan Marrëveshjen për Normalizimin e Marrëdhënieve Ekonomike në Shtëpinë e Bardhë. Marrëveshja përfshinte projekte konkrete infrastrukturore si autostrada e Paqes Prishtinë - Merdar dhe një linjë hekurudhore në të njëjtën rrugë, për ta lehtësuar lëvizjen dhe tregtinë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Megjithëse projekti i

autostradës ka vazhduar në të dyja anët, ai mbetet ende i papërfunduar tërësisht. Një element tjetër kyç ishte studimi i fizibilitetit për liqenin e Ujmanit, i cili shtrihet në kufirin Kosovë - Serbi. ShBA-ja e ka përfunduar këtë studim në qershor të vitit 2021 dhe ka propozuar një model të përbashkët menaxhimi. Grenelli, madje, ka sugjeruar që liqeni të riemërohej "Liqeni Trump", një propozim i cili kishte marrë mbështetje nga Hoti dhe zyrtarët serbë, edhe pse kishte reagime të përziera nga publiku. Gjithashtu, Grenelli ka ndërmjetësuar një marrëveshje në janar të vitit 2020 ndërmjet Kosovës, Serbisë dhe kompanisë gjermane "Lufthansa" për të krijuar një linjë ajrore direkte Prishtinë - Beograd. Trumpi e kishte përshkruar këtë si "një tjetër fitore", por linja ende nuk është realizuar në praktikë. Ndërmjetësimi i Trumpit i kishte sjellë Kosovës edhe njohjen nga shteti i Izraelit. Ndryshe nga kjo periudhë, marrëdhëniet e administratës Trump, në veçanti të Grenellit me Albin Kurtin, ishin të tensionuara. Kurti, kur ka marrë për herë të parë detyrën në fillim të vitit 2020, përplasej shpesh me Grenellin, i cili e ka kritikuar publikisht, duke e cilësuar Kurtin "anti-amerikan" dhe duke e akuzuar se i kishte

kundërshtuar politikën amerikane të sugjeruar nga ish-presidentët Bill Clinton, Barack Obama dhe Donald Trump. Tensionet kanë kulmuar në marsin e 2020-s, kur qeveria e Kurtit është rrëzuar nëpërmjet një mocioni mosbesimi, për të cilin Kurti kishte pretenduar se ishte orkestruar me mbështetjen e Grenellit. Një nga pikat e tensioneve ishte edhe një tarifë doganore prej 100-përqindësh ndaj mallrave me origjinë nga Serbia e vendosur nga qeveria Haradinaj më 2018. Sipas Kurtit, Grenelli ka kërkuar heqjen e tarifës pa masa reciproke, gjë që Kurti e kundërshtoi fuqimisht. Kurti, gjithashtu, e kishte akuzuar Grenellin për ndërhyrje të drejtpërdrejtë në krizën politike në Kosovë, duke thënë se ai kishte propozuar një marrëveshje me Serbinë për këmbim territorial dhe se një marrëveshje e tillë "nuk mund të ishte një marrëveshje paqeje". Grenelli, nga ana e tij, e ka përshkruar Kurtin si një "problem" dhe ka vazhduar të argumentonte se qasja e tij ishte e nevojshme për t'i avancuar interesat amerikane në Ballkan. Edhe pas përfundimit të mandatit të parë të Trumpit, kritikën e Grenellit ndaj Kurtit nuk kanë reshtur. Në verën e vitit 2023 Grenelli

Joseph: Kurti do të përballet me zgjidhje të vështira nëse Grenelli emërohet në ndonjë pozitë të lartë në politikën e jashtme

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mbase do të kishte dashur ta ndryshonte qasjen e tij nën administratën e presidentit Joe Biden, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin "John Hopkins" në ShBA, pas fitores së Donald Trumpit në zgjedhjet e mbajtura më 5 nëntor.

Joseph ka shtuar se Kurti do të përballet me zgjidhje të vështira, veçanërisht nëse Richard Grenelli, i cili ka qenë shumë kritik ndaj Kurtit, emërohet sekretar i Shtetit, apo në ndonjë pozitë tjetër të lartë në politikën e jashtme.

"Në Serbi po e festojnë fitoren e Trumpit. Richard Grenelli, të cilin Trumpi e përmendi në një tubim rishtazi, ka mundësi ta mbajë një pozitë të lartë, madje edhe pozitën e sekretarit të Shtetit. Grenelli për kohë të gjatë ka pasur mospajtime me Albin Kurtin dhe ka vazhduar kritikën edhe këtë vit", ka thënë Joseph.

Në vitin 2020 Kurti e kishte akuzuar Richard Grenellin, i cili gjatë administratës Trump ishte përfaqësues amerikan në dialogun Kosovë - Serbi, se ishte "drejtpërdrejt i përfshirë" në rrëzimin e qeverisë së tij me pak se dy muaj pasi mori detyrën si



kryeministër. Në atë kohë Grenelli kishte thënë se Kurti ishte anti-amerikan dhe se ai ka qenë kundër politikave amerikane të sugjeruara nga ish-presidentët amerikanë: Bill Clinton, Barack Obama dhe Donald Trump. "Kryeministri Kurti do të presë zgjedhjet [në Kosovë] - dhe pastaj do t'i duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me njëanshmëri dhe shpërfillje ndaj Shteteve të Bashkuara. Ai, mbase, mund të kishte dëshiruar ta ndryshonte kursin nën administratën Biden. Qëndrimi më i mirë i Kurtit është ai për të cilin unë kam bërë thirrje gjithmonë: je

kryeministër i të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe tregojni serbëve se Prishtina i mbrojnë interesat e tyre më shumë se Beogradi", ka thënë ai. Duke komentuar kthimin e Trumpit në Shtëpinë e Bardhë, Joseph ka thënë se populli amerikan injoroi gjithçka që dinte për Trumpin. "Kjo është vërtet pika më befusuese. Është aftësia e kaq shumë mbështetësve të Trumpit për të ndarë në kategori të veçanta të kaluarën dhe skandalet e vazhdueshme të tij, si dhe fyerje dhe madje nxitje e hapura për dhunë. Tri ditë më parë, në një tubim në Pensilvani, ai sugjeroi se nuk do t'i

interesonte nëse gazetarët do të qëlloneshin me armë. E tha këtë si një 'shaka' - në një vend ku dhuna me armë nuk është aspak shaka. Nuk ka as zemërim dhe as shqetësim për një koment të tillë mes mbështetësve të tij. Dhe ky është vetëm një shembull", ka shpjeguar ai.

Ai ka shtuar, gjithashtu, se përtej kësaj ekziston edhe e kaluara e tij në politikën e jashtme, "e cila i shpëton çdo lloj kontrolli". "Qasja e tmerrshme e Trumpit në negociatat për Kim Jong Un. Vendimi i Trumpit për të hequr dorë nga marrëveshja bërthamore me Iranin - një vendim me gjasë vetëm për t'i bërë dëm Obamas - ishte

katastrofike. Ishte Trumpi ai që negocioi me talebanët për ta nxituar tërheqjen nga Afganistani, të cilën Bideni vetë e zbatoi në mënyrë katastrofike", ka thënë Joseph. Ata që kanë votuar për Trumpin, sipas Joseph, si çështje që i shqetësonte më së shumti ishin ekonomia dhe emigracioni. "Lidhur me inflacionin, politikën thelbësore të Trumpit për rritjen e tarifave posaçërisht ndaj mallrave kineze, do t'i rrisin çmimet. Kjo është poenta e tarifave: rritja e çmimit të një malli të importuar. Pra, kjo mosvazhdimësi flagrante injorohet", ka përfunduar Joseph.

Çitaku: Raportet me ShBA-në varen edhe nga kush udhëheq institucionet e Kosovës



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vjola Çitaku, ka thënë se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk varen vetëm nga kush është në Shtëpinë e Bardhë, por edhe kush i udhëheq institucionet e Kosovës", ka thënë Çitaku për "EO". Ajo është shprehur se raportet ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së patën arritur një nivel që nuk është parë më herët. "Në katër vitet e fundit në ShBA ka qenë Joe Biden, i cili deri në detaje është i familjarizuar me çështjen e Kosovës. Përkundër kësaj, për shkak të sjelljes së papërgjegjshme të kryeministrit Kurti, të institucioneve të Kosovës, raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së patën mbërritur në nivel të cilin nuk e kemi parë më herët. Pra, ne në Kosovë duhet të përqendrohemi në zgjedhjet tona që i kemi më 9 shkurt sepse natyra e raporteve të Kosovës jo vetëm me ShBA-në, por edhe me BE-në, varet në masë të madhe edhe nga udhëheqësit e institucioneve të Kosovës", ka thënë Çitaku.

ka komentuar veprimet e Kurtit në veriun e Kosovës, sidomos në komunat me shumicë serbe, duke i cilësuar si veprime që rrezikonin stabilitetin e rajonit.

Administrata aktuale e ShBA-së nën udhëheqjen e presidentit Joe Biden, gjithashtu, ka kritikuar disa nga veprimet e njëanshme të Kurtit, veçanërisht në veri të vendit, duke i cilësuar të dëmshme për marrëdhëniet me Uashingtonin.

Në gusht, Grenelli ka kritikuar ashpër Kurtin në rrjetet sociale, duke theksuar se "Kurti është problem". Pavarësisht prej kësaj, kryeministri aktual Albin Kurti e ka uruar Trumpin për fitoren, duke thënë se mezi pret "të punojmë së bashku për përparim dhe paqe".

Edhe liderët e partive opozitare në Kosovë e kanë uruar Trumpin për fitoren në zgjedhjet e 5 nëntorit.

Mandati i dytë, "pozitiv ose shumë negativ"

Në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë", profesori Afrim Hoti nga Universiteti i Prishtinës e konsideron zgjedhjen e Donald Trumpit president të ShBA-së si një zhvillim pozitiv për Kosovën dhe Ballkanin.

Hoti beson se administrata e Trumpit mund të sjellë energji të reja në marrëdhëniet e ShBA-së me Kosovën dhe rajonin. "Unë dua të besoj se kushdo që i udhëheq institucionet e Kosovës duhet të jetë i vetëdijshëm se ka pak rëndësi fakti se kush e udhëheq Shtëpinë e Bardhë. Pra, cila administratë udhëheq ShBA-në, sepse si me njërin, ashtu edhe me tjetrin, institucionet tona kanë pasur raporte të ngushta", ka thënë ai.

Hoti, gjithashtu, ka theksuar se Kosova duhet t'i forcojë përpjekjet e lobimit me ShBA-në për të ruajtur këtë marrëdhënie të rëndësishme pasi, sipas tij, ky lobim është rritur shumë në Serbi. "Tashmë gjërat kanë ndryshuar dhe tashmë serbët janë në ofensivë, ata po llojnë me të madhe. Përfundimisht, institucionet tona duhet të jenë të vetëdijshme për këto veprime dhe ta ripozicionojnë vendin karshi ShBA-së", ka thënë Hoti. Në anën tjetër, Toby Vogel ka parashikuar se Ballkani nuk do të jetë shumë lart në agjendën e Trumpit, por beson se çfarëdo ndikimi që administrata e tij do të ketë në rajon, "nuk do të jetë pozitiv". Më konkretisht, ai përmend mundësinë e ringjalljes së skemës së "këmbimit të

territoreve", ku Serbia mund ta aneksojë veriun e Kosovës dhe që, sipas tij, nuk mund të përfundojë paqësisht. "Evropianët nuk janë të gatshëm ta kundërshtojnë këtë - në fakt, herën e fundit kur u diskutua seriozisht kjo ide ishte nën iniciativën e shefes së politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, më pas u mor nga administrata e Trumpit", ka thënë Vogel.

Përveç kësaj, ai ka paralajmëruar se kryeministri Kurti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq mund të përpiqen të krijojnë "fakte në terren", veçanërisht në veri të Kosovës dhe se "Kurti mund të ndihet i detyruar të veprojë para inaugurimit të Trumpit dhe zgjedhjeve në Kosovë në shkurt".

Veriu i Kosovës i banuar me shumicë serbe ka qenë në vazhdimësi vatër e tensioneve në Kosovë me qëllim në atë zonë kundërshtohet pavarësia e Kosovës. Një sulm i fundit i armatosur në shtator të vitit 2023 la të vrarë një polic të Kosovës.

Megjithatë, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ishte ndër të parët në rajon që ia uroi fitoren Trumpit, dhe rezultatit zgjedhor iu gëzuan edhe qytetarë serbë në veri të Kosovës.

Kelmendi dhe shefi i EELEX-it bisedojnë për sundimin e ligjit në Kosovë

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur në takim shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, me bashkëpunëtorë. Në njoftimin për medie është bërë me dije se ata kanë pasur diskutime konstruktive dhe përbashkëpunuese lidhur me

çështjet e interesit të përbashkët, përfshirë rëndësinë e avancimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në proceset institucionale, nevojën për ruajtjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor ku bën pjesë edhe sistemi prokurorial, si dhe ngritjen e koordinimit në çështjet që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. “Duke

e vlerësuar lart angazhimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë në monitorimin e punës së sistemit prokurorial, u. d. kryeprokurori Kelmendi ka potencuar se EULEX-i mbetet një nga partnerët më të rëndësishëm të institucionit të Prokurorit të Shtetit”, ka njoftuar Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.



AAK-ja: Miratimi i planit hapësinor, detyrë urgjente



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kritikuar vonesat në miratimin e Planit Hapësinor dhe Hartës Zonale të Kosovës, duke theksuar se mungesa e këtyre dokumenteve është duke penguar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, veçanërisht sektorin e turizmit malor.

“Mungesa e Planit Hapësinor dhe Hartës Zonale po shkakton zhvillim të paorganizuar, dëmtim të mjedisit dhe kufizim të investimeve strategjike”, është thënë në reagimin e AAK-së.

Sipas subjektit politik, komunat dhe investitorët janë

duke u ballafaquar me vështirësi të mëdha në vendimmarrje dhe në procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit.

Partia opozitare ka theksuar se miratimi i këtyre dokumenteve do të mundësonte zhvillimin e integruar të turizmit malor, duke identifikuar zonat me potencial të lartë turistik dhe duke ofruar siguri për investitorët.

“Një qeveri e ardhshme e Aleancës do të angazhohet në thjeshtësimin e procedurave për lejet ndërtimore dhe hartimin e një ligji të posaçëm për zonat turistike malore”, është thënë në reagimin e AAK-

së, duke shtuar se do të aplikohen politika fiskale stimuluuese për investitorët që përbushin standardet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky subjekt politik ka paralajmëruar se situata aktuale rrezikon ta dëmtojë mjedisin përmes ndërtimeve të pakontrolluara dhe të pengojë rritjen e mirorganizuar të vendit. Po ashtu, AAK-ja ka propozuar një sërë masash konkrete, përfshirë përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e natyrës dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërkomunal për menaxhimin e destinacioneve turistike malore.

LDK-ja dorëzon në Kushtetuese Ligjin për Zyrtarët Publikë



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Zyrtarët Publikë bashkë me ndryshim dhe plotësimet e tij. Ky ligji është dorëzuar në Kushtetuese nga deputeti Armend Zemaj dhe anëtar i kësaj partie, Shkëmb Manaj.

Deputeti Zemaj ka thënë se Vetëvendosja është duke synuar ta kapë administratën publike. “Një ligj i cili ka kaluar nëpër Kuvendin e Kosovës dhe i cili, po ashtu, ka qenë si vendim i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë e disa akteve të cilat kanë të bëjnë me ndërhyrjen direkte në administratën publike, në logjikën e pushtetit të Vetëvendosjes për kapjen e

zyrtarëve publikë dhe politizimin e skajshëm, i cili dëmton edhe administratën në tërësi, por e dëmton edhe ecjen e Kosovës drejt integriteteve evropiane”, ka thënë Zemaj, duke shprehur besimin e plotë se Kushtetuesja do të marrë një vendim i cili është në plotëni me Kushtetutën. “LDK-ja mendon se nuk duhet të lejohet një administratë tërësisht e politizuar, sidomos një administratë në të cilën është investuar shumë që të jetë e pavarur dhe t’i ushtojë detyrat e saj sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, është shprehur Zemaj në një prononcim për medie.

Zemaj ka thënë se pushteti i Vetëvendosjes nuk ka marrë parasysh rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe të Komisionit të Venecias.

Ambasadori britanik viziton burgun e grave në Lipjan

LIPJAN, 7 NËNTOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka vizituar të enjten Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, ku ka zhvilluar një takim me drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), Ismail Dibrani dhe

drejtorin e kësaj qendre, Ylber Topalli. Sipas njoftimit të ShKK-së, Hargreaves ka shprehur mbështetjen e vazhdueshme të Britanisë së Madhe për përmirësimin e sistemit korrektues në Kosovë dhe ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë

për arritjen e rezultateve edhe më të mira në të ardhmen.

“Në fund të takimit, në shenjë falënderimi, drejtori Dibrani dhe drejtori Topalli i dhuruan ambasadorit Hargreaves punime filigrani të realizuara nga të burgosurat e Qendrës Korrektuese për Femra në Lipjan”, ka njoftuar ShKK-ja.



Buja: Krasniqi ka qenë zëdhënës i UÇK-së, s'ka pasur të bëjë me detyra operative

HAGË, 7 NËNTOR - Dëshmitari Shukri Buja ka thënë të enjten në Hagë se Jakup Krasniqi ka qenë zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe është marrë me detyra operative. "Ka qenë zëdhënës i UÇK-së, detyrat operative nuk kanë kuptim", ka thënë Buja, i cili për disa ditë ka dëshmuar në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Një gjë të tillë Buja e kishte thënë edhe në gjykimin ndaj Fatmir Limajt në vitin 2005 dhe se këtë përgjigje ai e dha gjatë kundërpvetjeve të avokates së Krasniqit, Shyamala Alagendra.

pritur me padurim për shkak të personalitetit të tij. "Jakup Krasniqin në emërimin si zëdhënës i UÇK-së e kam pritur me padurim sepse ka qenë një personalitet i jashtëzakonshëm. Një njeri që ka pasur vizion politik të jashtëzakonshëm dhe ka qenë një njeri që është pritur në mënyrë jashtëzakonisht të mirë nga popullata civile", ka thënë Buja, duke shtuar se Krasniqin e ka takuar rreth qershorit 1998.

Nga dalja publike si zëdhënës i UÇK-së, Buja ka thënë se është kuptuar se Krasniqi ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Ai ka thënë se detyra operative në UÇK gjatë verës kanë pasur Azem Sylja si



komandant i përgjithshëm dhe Sokol Bashota si zëvendës i tij. Ndërsa në korrik të '98-s, sipas tij, Bislim Zyrapit ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm e që edhe kjo ishte një detyrë

operative.

Në pyetjet e avokatit të Veselit, Rodney Dixon, dëshmitari Buja ka thënë se e kishte kuptuar që Veseli në periudhën maj-qershor ka qenë ministër i

Shërbimit Informativ të Kosovës. "Në muajin maj ka dalë informacioni për ministrat në kuadër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës", ka thënë Buja.

Buja ka thënë se nuk ishte përgjegjës i Ilmi Reçicës për t'i zbatuar rregullat disiplinore dhe nuk kishte të bënte me asnjë lloj hetimi sa iu takon çështjeve disiplinore. "Nuk ka qenë detyrë e zbulim-kundërzbulimit. Ka qenë detyrë e Policisë Ushtarake dhe e komandantit të brigadës", ka thënë Buja.

Ai ka pohuar se ZKZ-ja dhe Policia Ushtarake nuk kishin të bënin me njëri-tjetrin pasi ishin të ndara nga funksionimi.

Haxhiu: Për asnjë rast të dhunës në familje nuk është shqiptuar dënimi maksimal

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave duhet të bëhet pjesë e integruar e dënimeve për kryesit e këtyre veprave penale. Kështu është thënë në tryezën "Thyerja e ciklit të dhunës: integrimi i programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje si pjesë e dënimit", e cila është organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në kuadër të projektit "Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit".

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka shprehur optimizëm se në të ardhmen gratë në Kosovë do të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme,



derisa ka theksuar se institucionet përgjegjëse duhet t'u përgjigjen me profesionalizëm rasteve të dhunës në familje. Haxhiu ka

theksuar se deri më tani në asnjë rast të dhunës në familje nuk është shqiptuar dënimi maksimal që parashihet në Kodin Penal e që është 3 vjet.

E para e drejtësisë në vend, Albulena Haxhiu, ka thënë se Programi Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave synon ta transformojë mendësinë dhe sjelljet abuzive të kryesve si dhe t'i vetëdijesojnë kryesit e dhunës për pasojat e rënda të veprimeve të tyre. Ajo ka thënë se për ofrimin e këtij programi janë trajnuar 15 profesionistë, derisa ka theksuar se pilotprojekti është implementuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe pjesë e trajnimit kanë qenë 20 persona që kanë kryer veprën penale dhunë në familje. Ndërsa zëvendës shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në

Prishtinë, Tankut Soykan, është shprehur i kënaqur me punën që ministria e Drejtësisë ka bërë për hartimin e Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryesve të Dhunës ndaj Grave. Soykan ka thënë se kryesit e dhunës në Kosovë dalin nga burgu me të njëjtën mentalitet, prandaj ai e sheh të nevojshme që programe të tilla të jenë pjesë e integruar si pjesë e shqiptimit të dënimeve.

Në nëntor të vitit 2023 Ministria e Drejtësisë ka lansuar "Programin Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave", i cili është pilotuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë për 6 muaj.

Miratohet me vërejtje Rregullorja e Punës e Komisionarit Parlamentar për FSK-në

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes ka votuar me vërejtje Rregulloren e Punës të Komisionarit Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Shqipe Selimi, ka paraqitur vërejtjet e saj për këtë rregullore. "Unë i kam vërejtjet e mia në 7 nene, në disa pika, mbi të gjitha në gramatikën e kësaj rregulloreje. Gjuha shqipe është pothuajse e bastarduar në disa nene. Unë nuk jam një nga ato që do ta votoj këtë rregullore për arsyt e mia. Dua t'i jap propozimet e mia se si të ndryshohet ajo", ka thënë Selimi.

Ndërsa deputeti i pushtetit, Enver Dugolli, ka thënë se

gabimet gjuhësore nuk janë bazë për kundërshtim të rregullores, duke pasur parasysh se deputetët nuk zotërojnë shkollim për gramatikën gjuhësore. "Jemi munduar të bëjmë me kohën, tashmë jemi ngushtë me kohën dhe nëse mund të bëjmë me procedurë të përshpejtuar. Nëse nuk miratohet tani në këtë legjislaturë, i bie që edhe vitin e ardhshëm të mos ketë funksionalizim të kësaj zyre. Jam i pajtimt që kjo të bëhet në procedurë të përshpejtuar. Ne si grup punues kemi përshpejtuar për të zënë hapin që të miratohet kjo pikë rregullore", ka thënë Dugolli.

Ndërsa deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Anton Quni, ka kërkuar



diskutim të çdo neni që kundërshtohet nga anëtarët e komisionit. Sipas tij, ky institucion ka për qëllim të përcaktohen rregullat dhe metodologjia e punës. "Pas 10 viteve rrugëtim për ta funksionalizuar këtë institucion, jemi në përfundim

që ky institucion ta fillojë punën sa më parë. Si obligim ligjor është paraparë të harrohet Rregullorja e Punës e Sigurisë së Kosovës e cila ka për qëllim të përcaktohen rregullat dhe metodologjia e punës. Ne kemi pasur një vizitë në Norvegji, jemi takuar me komisionarin

nga Forcat e Armatosura norvegjeze, dhe duke marrë ekspertizat dhe njohuritë e tyre, kemi ardhur në një draft të mirë, që ky institucion të funksionalizohet sa më shpejt", ka thënë Quni.

Kurse deputeti i PDK-së, Hisen Berisha, ka theksuar se duhet t'i hapet rrugë komisionares së FSK-së. "Më duket që edhe në strukturë, por edhe në operacionalitet, ngjason kjo zyrë me praktikën më të mirë me përvojat në Gjermani dhe shtete të tjera. Nëse duam që t'i hapim këtë mundësi komisioneres të veprojë në këtë formë dhe t'ia lehtësojmë punën edhe FSK-së, atëherë kemi menduar të shkojmë me një procedurë që të mbyllet brenda vitit", ka thënë Berisha.

FOL-i kritikon qeverinë për projektbuxhetin e vitit 2025: Po propozon praktika të gabuara ligjvënëse

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Lëvizja FOL ka thënë se qeveria Kurti përmes dispozitës së nenit 33 të Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 është duke vendosur një praktikë të dëmshme juridike dhe ligjvënëse, duke ndërhyrë në Ligjin për Pagat në sektorin publik. "Qeveria e Republikës së Kosovës përmes dispozitës së nenit 33 të Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, i cili i është propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, po vendos një praktikë të dëmshme juridike dhe ligjvënëse, duke ndërhyrë në Ligjin për Pagat në sektorin publik", është thënë në reagimin e FOL-it.

FOL-i ka thënë se neni 9 ka përcaktuar se vlera monetare e koeficientit të pagave të

punëtorëve në sektorin publik të përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit dhe se nuk e autorizon qeverinë ta ndryshojë strukturën e koeficienteve. "Përkatësisht, neni 9 i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik ka përcaktuar se vlera monetare e koeficientit të pagave të të punësuarve në sektorin publik të përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit, ndërsa në asnjë rast nuk e ka autorizuar Qeverinë e Republikës së Kosovës që me ligjin vjetor të buxhetit të ndryshojë strukturën e koeficienteve, veçse të përcaktuar në Ligjin për pagat në sektorin publik", është thënë në këtë reagim.

Sipas FOL-it, kjo praktikë ka ngjallur shqetësime për mënyrën e ndjekur, pasi nuk respekton në tërësi dispozitat e Ligjit për pagat në sektorin publik, i cili është ligj special (lexspecialis) që



përcakton në detaje strukturën dhe nivelet e pagave në sektorin publik. Ndryshimi i tij përmes një ligji tjetër special, siç është Ligji vjetor mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, krijon precedent të gabuar në praktikën ligjore dhe ligjvënëse, duke anashkaluar procedurat e zakonshme për ndryshime ligjore në Kuvend. Ndryshimet në Ligjin për Pagat përmes Ligjit për buxhetin mund të ngjallin

pikëpyetje për koherencën dhe qëndrueshmërinë e sistemit ligjor. Për më tepër, kjo praktikë mund të hapë rrugën për ndryshime të tjera të ligjeve specifike përmes ligjeve të ndryshme në të ardhmen, gjë që mund të përdoret në mënyrë të papërshtatshme", është thënë në reagim.

Më tutje, FOL-i ka theksuar se ndryshimet në ligje duhet të kryhen përmes procedurave legislative të parashikuara.

"Ndryshimet në ligje duhet të kryhen përmes procedurave legislative të parashikuara, duke respektuar parimet e transparencës dhe përfshirjes së akterëve të interesuar. Vetëm kjo garanton që çdo ndryshim të jetë i studiuar mirë, i qëndrueshëm dhe të përputhet me parimet kushtetuese dhe ligjore", është thënë në reagimin e FOL-it.

FOL-i ka kërkuar nga deputetët që ta mbrojnë integritetin e sistemit ligjor të Kosovës. "Rrjedhimisht, kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës të veprojnë me përgjegjësi dhe të mbrojnë integritetin e sistemit ligjor të Kosovës, duke siguruar që çdo ndryshim ligjor të jetë i miratuar vetëm në përputhje me procedurat dhe parimet kushtetuese dhe ligjore, për të shmangur precedentët e rrezikshëm që mund të dëmtojnë interesat e qytetarëve", është thënë në reagimin e FOL-it.

Gjykata Komerciale shihet si "shpëtim" për bizneset

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar konferencën vjetore të drejtësisë komerciale "Drejtësia dhe biznesi", e cila shtjellon njohuritë për reformat ligjore dhe mekanizmat e zgjidhjes së kontesteve tregtare. Në këtë konferencë është thënë se një proces gjyqësor i drejtë është i rëndësishëm jo vetëm për tërheqjen e investimeve, por edhe për rritjen e përgjithshme ekonomike. Me këtë reformë synohet të zhvillohet edhe më tej sistemi gjyqësor, edhe të lehtësohen sfidat e bizneseve.



Kryetari i OEAK-ut, Arian Zeka, ka thënë se një proces gjyqësor i drejtë dhe efikas

është i rëndësishëm edhe për tërheqjen e investimeve të huaja. Zeka ka thënë se të

bërit biznes në Kosovë ka sfida, por që me themelimin e Gjykatës Komerciale ka shpresë që këto vështirësi për bizneset të lehtësohen. "Jemi për ta dëshmuar përkushtimin e përbashkët dhe përforsimin e sistemit të drejtësisë komerciale të Kosovës i cili është thelbësor për një mjedis biznesi elastik i cili mundëson lulëzimin e bizneseve. Një proces gjyqësor i drejtë, efikas dhe transparent është i rëndësishëm jo vetëm për tërheqjen e investimeve, por edhe për ndërtimin e besimit në sistemin e përgjithshëm e padyshim edhe për rritjen e

gjithmbarshme ekonomike të vendit ashtu që Kosova të mund të jetë konkurruese në skenën rajonale dhe ndërkombëtare. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka kryer me anëtarët e saj një anketë që të raportohet si një gjykatë efektive dhe efikase në kryerjen e punëve të saj edhe pse gjithmonë ka hapësirë për përmirësim", ka thënë Zeka. Ndërsa zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka thënë se si ekzekutiv kanë shprehur gatishmëri në vazhdimësi t'i ndihmojnë bizneset për t'ua bërë sa më të lehtë punën.

Rritet numri i ndërmarrjeve të reja, vetëm në shtator u regjistruan 996 shosh

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Në muajin shtator të këtij viti janë regjistruar gjithsej 996 ndërmarrje, e që është një rritje prej 9.4 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. "Në shtator 2024 krahasuar me muajin gusht 2024, kemi rritje për 9.4 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara, ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, kemi rritje për 9.4 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara", është thënë në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Sipas këtij raporti, kryesojnë

"mikro ndërmarrjet", pasi vetëm në shtator janë regjistruar 985 nga gjithsej 996 ndërmarrje të regjistruara, ndërsa nuk ka të regjistruara asnjë nga ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. "Në kategorinë 'Mikro ndërmarrje' (1 deri në 9 të punësuar) janë gjithsej 985 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë 'Ndërmarrje të Vogla' (10 deri 49 të punësuar) janë gjithsej 11 ndërmarrje të regjistruara, kurse në kategorinë 'Ndërmarrje të mesme' dhe 'Ndërmarrje të mëdha' nuk kemi ndërmarrje

të regjistruara këtë muaj", është thënë në raportin e ASK-së. Më tutje, sipas ASK-së, aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë shtatorit ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 234 (23.5 për qind), ndërtimtari me 120 (12 për qind), prodhim me 105 (10.5 për qind), aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 98 (9.8 për qind), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 84 (8.4 për qind) etj. Sa i përket shtrirjes gjeografike



të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve: rajoni i Prishtinës prin me 449 ndërmarrje të regjistruara (45.1 për qind), rajoni i Prizrenit me 121 (12.1 për qind), rajoni i

Ferizajt me 102 (10.2 për qind), rajoni i Gjilanit me 95 (9.5 për qind), rajoni i Mitrovicës me 89 (8.9 për qind), rajoni i Pejës me 81 (8.1 për qind) dhe rajoni i Gjakovës me 59 (5.9 për qind).

“Game, set, match!” Nata më e gjatë e Amerikës dhe rikthimi i Trumpit

Donald Trump kthehet në mënyrë sensacionale në Shtëpinë e Bardhë, Elon Musk nuk mban dot gëzimin. Dhe mbi një mijë të ftuarit në Qendrën e Konventave të Hotelit Hilton, fillojnë festën. I hapur për miqtë, është republikan.

Eshtë mëngjes dhe kur Fox shpall zgjedhjen e Trump, salla shpërthen në thirrje Ju-Es-Ej (USA)! Presidenti ka fituar gjithçka: Shtatë shtetet e luhatura, votimin popullor, Senatin, Kongresin. Latinët ishin vendimtarë, me shumicë nuk pranuan të votojnë një grua. Të njëjtën gjë bënë edhe shumë zezakë.

Menjëherë është vënë në skenë spektakli i fitores, me mysafirë të spikatur, populli i tij, përfaqësuesit shumë të pasur dhe folkloristikë të klasave popullore. Milionerë të veshur me sqimë dhe motorristë me tatuazhe me xhupa lëkure, gra të stolitura dhe zezakë që mbajnë tabelën “Blacks for Donald”.

Nuk ka vonuar shumë Trumpi



për të marrë fjalën. “Eshtë një moment që do e mbaj mend për gjithë jetën, sepse është momenti më i madh i historisë së politikës amerikane”. Tetë vjet më parë kishte përmendur dhe falënderuar rivalen Hillary Clinton. Tani nuk e përmend Harrisin, por siguron se dëshiron “të kapërcejë ndarjet e

këtyre katër viteve”. Përreth kishte gjithë fëmijët, por publikut i prezantoi vetëm më të voglin, Barronin, i cili nuk është më vogëlushi që ishte në 2016. Ka puthur në faqe bashkëshorten, Melania, duke e lavdëruar për librin e saj që është një best-seller. Ka falënderuar Elon Musk, i cili

megjithatë nuk është shfaqur. Turma marroset, përpiqen të afrohen në skenë për ta fotografuar nga afër, ulërrasin “të dua!”.

Në prag të zgjedhjeve dihej. Një rezultat kokë më kokë do të zgjaste me ditë. Nëse fitonte Trumpi, përfundonte gjithçka menjëherë. Dhe në fakt ka

përfunduar. Uragani ka sjellë shira të papritura. Podiumi i The Donald ka qenë stil perandorak, i stolitur me pesëdhjetë flamuj amerikanë, një për secilin shtet si dhe nga po kaq shqiponja. Një solemnitet që i frymëzon falënderimin e Zotit.

Nata e gjatë

Nata në fakt dukej e pasigurt. Sigurisht, edhe skuadra e harris thoshte se kishte “ndjesi të mira”. Por sondazhi i fundit i porositur nga New York Times, një e përditshme sigurisht jo armiqësore ndaj saj, ka informuar se vetëm 40% e amerikanëve kanë një gjykim të favorshëm për administratën Biden-Harris. Vetëm 28 % mendonin se Amerika po shkonte në drejtimin e duhur. Nuk kish ndodhur kurrë që një parti në pushtet ta mbante Shtëpinë e Bardhë, duke patur këto shifra. Dhe verdikti ka qenë i qartë. Humbja e Kamalës është edhe më e rëndë se ajo e Hillary Clintonit. / bota.al

Trump 2.0. Donald bën sërish histori, ndërsa bota mban frymën

E quajnë “Akhenda 47” – një plan që shkakton dyshime tek presidenca e 47-të. Mund të titullohet edhe ‘Kthim në të Ardhmen’.

Baza e Donald Trump është e etur për “epokën e artë”, një Amerikë që ata besojnë se ka humbur.

Ai është në mision për t’ua rigjetur atyre.

Manjati i Nju Jorkut ka rimarrë pushtetin, duke sfiduar edhe imagjinatën e tij më të fortë.

Të rinjtë, zezakët, burrat latinë e pranuan Trump 2.0.

Anketuesit parashikuan një garë me rezultat të ngushtë. Në fund, ai fitoi me diçka që i ngjan një fitoreje masive – me republikanët që morën edhe Senatin.

Nëse mbajnë edhe Kongresin, do të jetë një pushtet i pakontrolluar – Trump mban çelësat e Shtëpisë së Bardhë dhe Kongresit.

Mijëra fjalë mund të shkruhen për Projektin 2025 – plani i fondacionit konservator Heritage për reformën radikale të qeverisë federale.

Por zotimi për të bërë Amerikën edhe një herë të Madhe shkon më thellë dhe është një fushatë që ka rekrutuar shumë tipa të jashtëzakonshëm.



Elon Musk – miliarderi dhe manjati i teknologjisë dhe njeriu më i pasur në botë – është në bord dhe së shpejti mund të marrë detyrën e Departamentit të Efikasitetit të Qeverisë. Robert F Kennedy Jr, i cili është i larguar nga pjesa tjetër e dinastisë së tij politike, pezulloi

kandidimin e tij për Shtëpinë e Bardhë për të mbështetur zotin Trump.

“RFK” është i njohur për vënien në dyshim të sigurisë së ujit të pijshëm dhe vaksinave. Presidenti i zgjedhur nuk e ka përjashtuar mundësinë që t’i japë atij përgjegjësi për

shëndetin.

Në fjalimet e fushatës zgjedhore, Trump ka paraqitur planet e tij për të investuar në makina fluturuese dhe për të ndërtuar “qytetet e lirisë” – pa rregulloret e qeverisë.

Në lidhje me imigracionin, ai premtoi dëbimin më të madh

masiv të emigrantëve të paligjshëm në historinë e SHBA-së, për të përfunduar ndërtimin e murit dhe për të zbatuar kontroll të rreptë kufitar.

Trump është zotuar se do t’i zhvendosë ata që flenë nga qendrat e qytetit në kampet me tenda derisa “problemet e tyre të mund të identifikohen”.

Por është lufta kulturele ajo që do të shkaktojë alarmin më të madh – nuk ka të drejtë kushtetuese për abort; mësuesve u kërkohet të “përqafojnë vlerat patriotike”.

Trump ka një politikë izolacioniste dhe kërkon të shkëputë Amerikën nga konfliktet globale, si në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme.

Ai është zotuar të shkurtojë “qindra miliarda” dollarë në ndihmë ndërkombëtare, t’i japë fund luftës në Ukrainë dhe potencialisht të tërheqë Amerikën nga NATO.

Ai kishte bërë tashmë histori – presidenti i parë që u bë kriminel i dënuar. Vetëm një tjetër ka fituar dy mandate jo radhazi.

Presidenti i 45-të i Shteteve të Bashkuara do të jetë edhe presidenti i 47-të dhe pjesa tjetër e botës mban frymën. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Driton Kuka lë të hapur mundësinë e kandidimit për president të KOK-ut



PEJË, 7 NËNTOR (ER) - Nuk përjashtohet mundësia që trajneri i mirënjohur i xhudos, Driton Kuka, të jetë kandidat për president të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Kuka të enjten në "Facebook" ka lënë të nënkuptohet se do të kandidojë për të parin e KOK-ut pasi, sipas tij, bordi aktual po punon kundër tyre. Në postimin e gjatë, Kuka ka

përmendur edhe medaljet olimpike të fituara në Paris si dhe zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Për një ditë të mirë... Olimpiada - Paris 2024 sollti dy medalje taze për shtetin tonë Kosovën e popullin shqiptar në total pesë! Xhudo kështu punon e funksionon me përkushtim! Distria vetëm dy copa. Në USA

zgjedhjet morën fund! Fitoj Trampi e unë pata dëshirë Harris, më gënjye s'ka. Zgjedhjet në KOK po afrohen. Kandidati për kryetar të kandidoj me ekip e jo ndryshe! Bordi i tanishëm ka shumë njerëz me interesa të ngushta, besa edhe përtej pak! S'ka vend për njerëz që anojnë kundër nesh aty", ka shkruar Kuka.

Jean-Denys Choulet sot vjen në Kosovë



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Përzgjedhësi i ri i Kosovës në basketboll, Jean-Denys Choulet, sot (e premte) do të vijë në Kosovë. Ai do të takohet me drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), më pas do të njoftohet me stafin e FBK-së.

Jean-Denys Choulet gjatë fundjavës do t'i përcjellë ndeshjet e javës së nëntë të Pro Credit

Superligës për ta parë formën e lojtarëve. Jean-Denys Choulet të hënën në një konferencë për media do t'i shpallë planet dhe synimet e tij me "Dardanët". Ndërkohë, më 12 nëntor, do të mbahet grumbullimi i parë i Kosovës. "Dardanët" në muajin nëntor do t'i zhvillojnë dy ndeshje si mysafirë. Më 21 nëntor do të ndeshen me Zvicrën, kurse më 24 me

Irlandën. Takimet zhvillohet në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2027. Kosova ka një fitore dhe një humbje. Sfidat e fundit do të jenë në shkurt të vitit të ardhshëm, kur do t'i presim Zvicrën dhe Azerbajxhanin. Siç dihet, Jean-Denys Choulet ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Federatën e Basketbollit të Kosovës.

SHKURT

Katër futbollistë shqiptarë në listën e Zvicrës

Federata Zvicerane e Futbollit ka bërë publike listën e lojtarëve të ftuar nga trajneri Murat Yakin për dy ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve kundër Serbisë dhe Spanjës. Ka katër fytyra të reja në listë për shkak të lëndimeve të shumta: Pascal Loretz i Luzernit, Miro Muheim i Hamburgut, Aurele Amenda i Eintracht Frankfurtit dhe Alban Hajdari i Luganos. Mungojnë Michel Aebischer, Becir Omeragic, Nico Elvedi (i pezulluar), Ulisses Garcia dhe Ruben Vargas. Janë në total katër lojtarë me origjinë shqiptare të ftuar për grumbullimin e radhës: përveç debutuesit Hajdari, janë thirrur edhe kapiteni Granit Xhaka, Adon Jashari dhe Andi Zeqiri. Lista e futbollistëve: Kobel, Loretz, Mvogo, Akanji, Amenda, Comert, Hajdari, Mbabu, Muheim, Rodriguez, Zakaria, Xhaka, Jashari, Fernandes, Freuler, Sierro, Sohm, Monteiro, Ugrinic, Kutesa, Rieder, Amdouni, Embolo, Ndoye, Okafor, Zeqiri.

Kampi Stërvitor i Xhudos po mbahet në Golem

Nga data 3 deri më 10 nëntor në Golem të Shqipërisë po mbahet kampi stërvitor i xhudos, i organizuar nga Federata e Xhudos e Kosovës dedikuar grupmoshave kadet, junior dhe senior. Kampi udhëhiqet nga kryemjeshtri Driton Kuka, i cili po ndan me sportistët pjesëmarrës përvojën e tij të pasur dhe teknikat e avancuara, duke ndihmuar zhvillimin dhe ngritjen e tyre në këtë sport. Kampi mbledh garues të xhudos nga të gjitha klubet në Kosovë, duke krijuar një atmosferë të fuqishme bashkëpunimi dhe avancimi për të gjithë sportistët, me fokus në përmirësimin e aftësive dhe përgatitjen për sfida të ardhshme.

Palokaj, gati për fitoren e radhës

Sportisti shqiptar me prejardhje nga Prizreni, Gjoni Palokaj, e ka meçin e radhës më 9 nëntor në Bratislavë. Kundërshtar i Palokajt është Rysavy, aspak i lehtë, por sportisti shqiptar është mjaft mirë i përgatitur dhe i gatshëm për fitore në Oktogon Liga MMA. Ky meç është i veçantë për Palokajn për faktin se Sllovakia nuk e njeh Kosovën shtet dhe sportisti nga Prizreni gjithmonë feston me simbole kombëtare. Gjoni trajnohet në shkollën "Fightschool" në Hannover, e cila është ndër më të mëdhatë në këtë qytet të madh të Gjermanisë. Kjo shkollë është e axhës së sportistit në fjalë, David Palokaj. Davidi është trajner i Gjonit.

Kosova mposhtet nga Ishujt Faroe

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll (meshkujt) e ka humbur ndeshjen e parë të fazës së dytë kualifikuese për "Euro 2026". Të mërkurën mbrëma në Torshavn, në atmosferë të bukur sportive, Kosova pësoi 32:21 nga Ishujt Faroe. Deri në minutën e 25-të ndeshja ishte e barabartë. Më pas vendësit nisën shkëputjen, ndërsa në pjesën e dytë mbajtën vazhdimisht epërsi bindëse. Më efikasit të Kosova ishin Valon Dedaj e Drilon Tahirukaj me nga katër gola. Nga tri i kishin Egzon Gjuka e Drenit Tahirukaj. Haris Berisha i kishte dhjetë pritje. Kosova udhëton për në Prishtinë. Të premten e të shtunën vazhdojnë përgatitjet për ndeshjen e së dielës ndaj Holandës, që zhvillohet të dielën nga ora 17:15 në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë.

Gjimshiti në formacionin e javës në Ligën e Kampionëve

BERGAMO, 7 NËNTOR - Berat Gjimeshi është në kulmin e karrierës së tij dhe këtë e tregojnë edhe vlerësimet që merr nga specialistët e futbollit për performancat e tij në Serinë A dhe në garat evropiane. "Sofascore", një sajt i specializuar për përpunimin

e statistikave të futbollistëve, e ka përfshirë mbrojtësin e Kombëtares Shqiptare në formacionin më të mirë të raundit të katërt të ndeshjeve në Ligën e Kampionëve. Gjimeshi dhe shokët e tij të mbrojtjes ishin të pakalueshëm në takimin me

Shtutgartin, e fituar 0-2 nga Atalanta. Mbrojtësi nga Lugina e Preshevës ra në sy jo thjesht për saktësinë në ndërhyrjet e tij, por edhe për lidhshirësinë në prapavijën e zikalterve të Bergamos. Rikthimi në formën më të mirë të Gjimeshitit është një lajm i madh edhe për

Kombëtares kuqezi në prag të dy sfidave të fundit të Ligës së Kombeve përballë Çekisë dhe Ukrainës në "AirAlbania".
Formacioni: Maignan, Gjimeshi, Flamingo, M. Kim, Kuhn, Sudakov, Tillman, Raphinha, Diaz, Kulenović, Gyokeres.



FC 2 Korriku U19 vulos kualifikimin historik në UEFA Youth League

PRISHTINË, 7 NËNTOR - FC 2 Korriku U19 ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm në UEFA Youth League, duke siguruar kualifikimin në fazën tjetër të këtij kompeticioni. Pas triumfit 2:1 në stadiumin "Fadil Vokrri", skuadra nga Prishtina arriti tjetër fitore të merituar 3:1 në përballjen e kthimit kundër ekipit irlandez, UCD nga Dublini, në kuadër të rrethit të dytë. Ky rezultat e dërgon FC 2 Korrikun në mesin e dhjetë skuadrave më të mira të Domestic Champions Path të UEFA Youth League, një arritje e jashtëzakonshme që pasqyron talentin dhe punën e palodhshme që po zhvillohet në futbollin e Kosovës. Dy gola për FC 2 Korrikun në këtë ndeshje i shënoi Rin Ahmeti e me një gol kontribuoi Omer Shala. Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, përgëzoi futbollistët, trajnerët dhe drejtuesit e klubit për këtë arritje të madhe. Në urimin e tij në rrjetet sociale ai shprehu krenarinë për paraqitjen e ekipit



dhe uroi suksese të mëtejshme në këtë rrugëtim. "Urimet më të përzemërta për FC 2 Korriku! Tjetër festë, tjetër natë magjike për futbollin e Kosovës në UEFA Youth League. Pas fitores 2:1 në stadiumin 'Fadil Vokrri', ekipi U19 i FC 2 Korrikut realizoi fitore edhe në ndeshjen e kthimit të rrethit të dytë kundër skuadrës irlandeze UCD nga Dublini, me rezultat 3:1, duke vulosur suksesin historik për klubin dhe futbollin tonë me kualifikimin në mesin e dhjetë skuadrave më të mira të Domestic Champions Path të UEFA Youth League. Ky sukses

është dëshmi e talentit të jashtëzakonshëm në vendin tonë dhe konfirmim i punës së shkëlqyeshme me gjeneratat e reja në klubin kryeqytetas. Përgëzoi futbollistët e rinj të FC 2 Korrikut për paraqitjen e jashtëzakonshme dhe prezantimin e denjë të futbollit tonë në këtë nivel të garave evropiane. Me këtë sukses ata na bënë krenarë të gjithëve. Urime edhe për stafin e trajnerëve dhe drejtuesit e klubit. Urime e ju priftë e mbara tutje! Vazhdoni të na bëni krenarë", ka shkruar Ademi.

SHKURT

Inzaghi pas fitores ndaj Arsenalit: Nuk duhet të ndalemi

Rrugëtimi i Interit në Ligën e Kampionëve mbetet i një niveli shumë të lartë. Trajneri Simone Inzaghi nuk mund ta fshihte kënaqësinë pas suksesit me rezultat minimal ndaj Arsenalit: "Kam marrë përgjigje të rëndësishme nga ata që luajnë më pak. Kur flasim për 23 titullarë, nuk e themi vetëm për hir të fjalës. Kjo fitore ishte shumë e rëndësishme. Kundërshtari u shfaq shumë intensiv dhe sinqerisht më duhet të them se Arsenali ishte një nga kundërshtarët më të mirë me të cilët jemi përballur. Ne e filluam mbarë, në pjesën e dytë u mbrojtëm mirë. Është krenari që jemi përballur shumë mirë me Cityn dhe Arsenalin. Po ruajmë një mesatare shumë të mirë pikësh, por kanë mbetur edhe katër ndeshje. Dy ndeshjet e ardhshme, me Leipzigun dhe Leverkusenin, do të jenë shumë sfiduese". Megjithatë, zikaltrit vuajtën jo pak përballë "topçinjve": "Skuadra tregoi kompaktësi. Kur je në një klub si ky nuk e zgjedh kompeticionin, por synon gjithmonë të luash sa më shumë ndeshje. Tani nuk duhet të ndalemi. Jam i lumtur me soliditetin që treguam ndaj një rivali shumë cilësor, si Arsenal".

Arteta: Dominuam ndaj njërit prej ekipeve më të mirë në Evropë

Trajneri Mikel Arteta këmbëngul se Arsenali nuk ka asgjë për t'u shqetësuar pavarësisht humbjes 1-0 ndaj Interit në Ligën e Kampionëve. "Topçinjët" janë pa fitore në tri ndeshjet e fundit të Ligës Premier dhe humbja nga Interi të mërkurën mbrëma çoi formën e tyre të dobët në katër ndeshje pa fitore. "Sigurisht që me numrin e rasteve që krijuam ne duhet të kishim shënuar dhe kjo varet nga ne", ka thënë Arteta. "Sidoqoftë mënyra se si luajti skuadra, ne ishim ne. Niveli i intensitetit, niveli i cilësisë, si arritëm në kuadrat dhe si dominuam në stadiumin e një prej ekipeve më të mira në Evropë. Jam shumë krenar për skuadrën time. Nëse luajmë kundër Chelseat siç luajtëm kundër Interit, ne mund të fitojmë", ka shtuar Arteta.

Dy klube angleze në garë për Sanen

Mesfushori gjerman Leroy Sane është pranë rikthimit në Premier Ligë. Lajm që konfirmohet nga "Bild". Kontrata e anësorit 28-vjeçar me Bayern Munichun skadon në fund të sezonit. Për momentin nuk ka asnjë lajm për rinovimin e saj, ndaj lojtari mund të largohet me koston zero verën e ardhshme. Për Sane është interesuar Arsenali, që synon një goditje të bujshme në merkato. Sane ka luajtur me Manchester Cityn. Skuadra e Arsenalit është vënë prej kohësh në ndjekje të Sanes, që duket se është gati të rikthehet në Angli, kurse si skuadër e interesuar për lojtarin gjerman është edhe Manchester Unitedi.

Golden State fiton në fushën e Bostonit, Clevelandi vazhdon pa humbje

BOSTON, 7 NËNTOR - Clevelandi mbetet skuadra e vetme pa asnjë humbje këtë sezon në NBA, duke kryesuar renditjen në Konferencën e Lindjes. Cavaliers fitoi me rezultat 131-122 në fushën e New Orleansit, sfidë ku u dallua Donovan Mitchell, autor i 29 pikëve. Fitore të rëndësishme jashtë fushës korri ekipi i Golden State, që falë 27 pikëve të Stephen Curryt fitoi me rezultat 118-112 në fushën e Bostonit dhe ngjiti shkallët në Perëndim. Vendimtar edhe stoli për miqtë, nga erdhën 49 pikë. Zhgënjeu ekipi i lakersave, që u mund me rezultat 131-114 në fushën e Memphisit. Le Bron James realizoi 39 pikë,



por që s'mjaftuan për të fituar. Në kahun tjetër, tre lojtarë të Memphisit realizuan nga 20 pikë, duke bërë dallimin. Humbjen e parë sezonale pësoi Oklahoman, që u mund në sekondat e fundit me rezultat 124-122 nga Denveri. Edhe pse të gjithë titullarët e

Oklahomës realizuan mbi 10 pikë, nuk evituan dot humbjen. Edhe te Denveri të gjithë titullarët realizuan në shifër të dyfishtë (Westbrook 29 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Detroit	108-107
Indiana - Orlando	118-111
Atlanta - New York	121-116
Boston - Golden State	112-118
Houston - San Antonio	127-100
Memphis - Lakers	131-114
New Orleans - Cleveland	122-131
Dallas - Chicago	119-99
Denver - Oklahoma	124-122
Phoenix - Miami	115-112
Clippers - Philadelphia	110-98
Sacramento - Toronto	122-107

Verstappeni: Ishte fundjava më e çmendur në Brazil

Max Verstappen është shumë pranë fitimit të titullit të katërt kampion bote në Formula 1. Triumfi në Brazil, në një pistë të lagur (Interlagos), në një garë që e nisi nga vendi i 17-të, ishte një leksion i mirë për rivalët e tij. Piloti holandez i Red Bullit ka kujtuar atë që ndodhi gjatë ditës së tij, që nisi keq dhe

përfundoi shkëlqyeshëm. Fillimisht ai zhgënjeu në provat zyrtare, ku u eliminua në sesionin e dytë dhe pas penalizimit me pesë pozicione e nisi garën nga vendet e fundit. "As nuk di nga të filloj sepse emocionet e mia shkuan nga përpjekja për ta shkatërruar garazhin në fitimin e garës.

Fillova në vendin e 17-të dhe e dija se mund të bëja një garë të mirë, por për mua ishte e qartë nga kualifikimi se ishte e mundur të ndiqja vetëm një linjë dhe se parakalimi do të ishte mjaft i vështirë", ka thënë Verstappen. "Megjithatë, bëra një start të mirë dhe një xhiro të mirë të parë dhe kjo më

ndihmoi. Strategjia për të qëndruar jashtë me goma të ndërmjetme shumë të konsumuara, pavarësisht shiut që binte, ishte vendimtare. Një bast që rezultoi i suksesshëm. Kemi qëndruar të qetë duke ditur që gara ishte ende shumë e gjatë", ka shtuar piloti holandez. "Ishte e rrezikshme,

por bëra zgjedhjet e duhura. Në një moment ishte e qartë se duhej një flamur i kuq, sepse ishte e pamundur të pilotohej edhe me goma ekstreme të lagura. Për shkak të ujit të madh në pistë, thuajse më duket sikur përdorimi ishte në një skaf", ka deklaruar Verstappen.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit

Sipas Ligjit nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Komisioni Shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim. Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues zgjedhet për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Kandidati për kryesues të Komisionit Shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 22 nëntor 2024, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Regulatornom autoritetu za usluge voda

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju usluga voda, Komisija za razmatranje se sastoji od predsedavajućeg, izabranog od strane Skupštine Republike Kosova, jednog člana imenovanog od strane Autoriteta i jednog člana imenovanog od strane pružioca usluga koji je podneo zahtev za razmatranje. Predsedavajući Komisije za razmatranje bira se za mandat od tri (3) godine, uz mogućnost ponovnog izbora za samo još jedan mandat.

Kandidat za predsedavajućeg Komisije za razmatranje treba da ispunjava sledeće uslove:

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje četvorogodišnju (4) univerzitetsku diplomu ili master;
- da nije bio osuđivan za krivična dela, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u profesiji.

Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđen za krivično djelo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 22. novembra 2024. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-180, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e dhjetë (10) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prej tyre së paku tre (3) anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve jo shqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku tre (3) anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve jo shqiptare dhe së paku katër (4) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.

Funksionet e Këshillit:

- Mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislationit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislationit për shërbimin civil.

Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku katër (4) vite përvojë pune në shërbimin civil apo zyrtar publik;
- Të jetë njohës mirë i legjislationit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitetet politike.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 27 nëntor 2024, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo, na osnovu člana 10. Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 08/L-180, raspisuje:

KONKURS

Za izbor deset (10) člana Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova, od njih najmanje tri (3) člana moraju biti iz ne albanske zajednice i najmanje dva (2) člana moraju biti ženskog pola

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

Sastav Odbora

Odbor se sastoji od petnaest (15) članova, koje bira Skupština Republike Kosova.

Od toga, najmanje tri (3) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje četiri (4) člana treba da budu ženskog pola.

Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i odlučuje o žalbama civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.

Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, moraju da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje sedam (7) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje četiri (4) godina rada u civilnoj službi ili kao javni službenik;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva;
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljanja iz civilne službe.

Mandat članova Odbora

- Članovi odbora biraju se za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat.
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju, da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV-autobiografija);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Prijave se dostavljaju najkasnije do 27. novembra 2024. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. "Majka Tereza" bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u


Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti sa potrebnim dokumentima. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regjionale Kuvendore e Ukitenime Osada

PASTRIMI sh.a. i.d.d.
Nr. 6719/11 dt. 06.11.2024
Prishtine - Prishtina



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit

KRM "Pastrimi" më datën 19/10/2024 ka hapur konkursin për pozitën Zyrtarë/e për menaxhimin e rrjeteve sociale dhe është mbyllur në datën 04/11/2024.

KRM "Pastrimi" vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Zyrtarë/e për menaxhimin e rrjeteve sociale nga data 06/11/2024 deri në datën 10/11/2024, ora 16:00.

Udhëzimet për aplikim mund t'i gjeni në konkursin bazë të publikuar në gazetë, në datën 19/10/2024.

Obaveštenje o produzenju konkursnog roka

RPO „Pastrimi“ je 19/11/2024. godine otvorio konkurs za poziciju Službenk za upravljanje društvenim mrežama i isti je zatvoren 04/11/2024.

RPO „Pastrimi“ nastavlja rok za raspisivanje javnog konkursa za funkciju Službenk za upravljanje društvenim mrežama od 06/11/2024 do 10/11/2024, 16:00 sata.

Uputstvo za prijavu možete pronaći u osnovnom konkursu objavljenom u novinama 19/10/2024.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



SWISS


TAVERNA



Tel: +377 45 400 156


+386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nazmi Kabashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Veprorë Emra shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Albulena Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

